

British American Tobacco – Albania Shpk

**Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
(me raportin e audituesve të pavarur)**

Përmbajtja

	Faqja
Raporti i Audituesve të Pavarur	i-iii
Pasqyrat financiare:	
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e flukseve monetare	4
Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	5-25

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Aksionarëve dhe Drejtimit të British American Tobacco Albania Shpk

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të British American Tobacco Albania Shpk (“Shoqëria”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019 si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”).

Baza e Opinionit

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (“SNA”-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar “Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare” të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës (“BKSNE”) dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë audituar nga një auditues tjetër i cili në datën 28 mars 2019, ka shprehur një opinion të pamodifikuar mbi këto pasqyra financiare.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që paraqiten në Raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe Raportin e drejtimit të brendshëm, përgatitur nga Drejtimi i Shoqërisë në përputhje me Nenet 17 dhe 19 të Ligjit Nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit mbi këto pasqyra. Opinionit ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim konkluzione që japin siguri lidhur me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lart dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare apo me kuptueshmërinë që kemi marrë gjatë auditimit ose në rast se përmbajnë anomali materiale. Nëse bazuar në punën që kemi kryer, ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë anomali materiale, atëherë, ne na kërkohet të raportojmë mbi këtë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në këtë drejtim.

Përgjegjësitë e drejtimit për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveç se sa më lart.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me drejtimin e Shoqërisë, ku përveç çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

Deloitte Audit Albania SHPK,

Deloitte Audit Albania SHPK
Rruga Faik Konica, Ndërtesa nr. 6 Hyrja nr 7, 1010,
Tiranë, Shqipëri
Numër unik identifikimi i subjektit (NUIS): L41709002H



Enida Cara
Partner Angazhimi
Auditues ligjor

29 prill 2020
Tiranë, Shqipëri

British American Tobacco – Albania Shpk
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek)

	Shënim	2019	2018
AKTIVE			
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	9	3,190,203	5,956,175
Aktive me të drejtë përdorimi	10	19,515,833	-
Total i aktiveve afatgjata		22,706,036	5,956,175
Aktive afatshkurtra			
Inventarë	11	524,962,832	387,511,520
Të arkëtueshme tregtare	12	229,792,785	350,619,077
Tatim fitim i parapaguar		6,739,022	7,477,506
Aktive të tjera	13	87,512,782	58,329,689
Mjete monetare dhe ekuivalentët me to	14	8,557,464	15,920,521
Totali i aktiveve afatshkurtra		857,564,885	819,858,313
TOTAL I AKTIVEVE		880,270,921	825,814,488
KAPITALI			
Kapitali aksionar	15	552,341,000	552,341,000
Humbjet e mbartura		(122,041,138)	(133,761,138)
TOTAL I KAPITALIT		430,299,862	418,579,862
DETYRIME			
Detyrime afatgjata			
Detyrimet e qirasë	17	8,363,432	-
Total i detyrimeve afatgjata		8,363,432	-
Detyrime afatshkurtra			
Të pagueshme tregtare	16	116,157,647	152,230,440
Detyrimet e qirasë	17	10,662,835	-
Detyrime të tjera	18	158,540,458	96,809,428
Provizione	19	73,821,420	74,656,440
Huatë	20	82,425,267	83,538,318
Total i detyrimeve afatshkurtra		441,607,627	407,234,626
TOTAL I DETYRIMEVE		449,971,059	407,234,626
TOTAL I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		880,270,921	825,814,488

Shënimet në faqet 5 deri në 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë autorizuar për publikim nga drejtimi i British American Tobacco-Albania Shpk më 29 prill 2020 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

Bakiri Z.

Administratore
Menaxhere e Financës

Brunilda Bakiri



Jetmira Cukaj

Asistent Menaxhere e Financës

Jetmira Cukaj

British American Tobacco – Albania Shpk**Pasqyra e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek)*

	Shënim	2019	2018
Të ardhurat	21	2,892,968,301	2,685,913,539
Kosto e shitjes	22	(2,631,924,384)	(2,428,159,754)
Fitimi bruto		261,043,917	257,753,785
Shpenzime tregtare	23	(116,043,425)	(100,964,370)
Shpenzime administrative	24	(195,161,434)	(175,212,808)
Të ardhura të tjera operative	25	81,055,031	52,895,704
Rezultati i veprimtarisë operative		30,894,089	34,472,311
Të ardhura financiare		1,406,502	21,434
Shpenzime financiare		(14,136,910)	(16,288,387)
Shpenzime financiare neto	26	(12,730,408)	(16,266,953)
Fitimi para tatimit		18,163,681	18,205,358
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	27	(6,443,681)	(10,503,546)
Fitimi për vitin		11,720,000	7,701,812
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		11,720,000	7,701,812

Shënimet në faqet 5 deri në 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

British American Tobacco – Albania Shpk
Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek)

	Kapitali aksionar	Humbje të mbartura	Totali i kapitalit
Më 1 janar 2018	552,341,000	(141,462,950)	410,878,050
Fitimi i vitit	-	7,701,812	7,701,812
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	7,701,812	7,701,812
Më 31 dhjetor 2018	552,341,000	(133,761,138)	418,579,862
Më 1 janar 2019	552,341,000	(133,761,138)	418,579,862
Fitimi i vitit	-	11,720,000	11,720,000
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	11,720,000	11,720,000
Më 31 dhjetor 2019	552,341,000	(122,041,138)	430,299,862

Shënimet në faqet 5 deri në 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

British American Tobacco – Albania Shpk
Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek)

	Shënimi	2019	2018
Flukset e parasë nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi para tatimit		18,163,681	18,205,358
<i>Rregullime për:</i>			
Shpenzime amortizimi	9	3,572,655	4,789,723
Shpenzime amortizimi aktive në përdorim	10	11,152,401	-
Provigjone neto të (rimarra)/krijuara	24	(835,021)	(1,132,766)
Shpenzime interesi	26	14,136,910	14,926,554
Të ardhura nga interesi	26	(21,464)	(21,434)
Shpenzim për humbje nga zhvlerësimi i të arkëtueshmeve tregtare	23	2,227,908	9,391
Fitimi neto nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	25	(597,518)	-
Diferencat në përkthimin e këmbimit valutor		222,661	-
		48,022,213	36,776,826
Ndryshime në:			
Inventarë		(137,451,312)	(187,270,054)
Të arkëtueshme tregtare		118,598,384	(18,781,487)
Aktive të tjera		(29,183,093)	22,675,157
Të pagueshme tregtare		(36,072,793)	82,172,222
Detyrime të tjera		61,731,030	35,285,992
Flukset e parasë (përdorur në)/gjeneruar nga veprimtaritë e shfrytëzimit		25,644,429	(29,141,344)
Interes i arkëtuar	26	21,464	21,434
Interes i paguar		(15,249,961)	(13,986,743)
Tatim fitimi i paguar		(5,705,198)	(26,515,026)
Flukset neto të parasë (përdorur në)/gjeneruar nga veprimtaritë e shfrytëzimit		4,710,734	(69,621,679)
Flukset e parasë nga veprimtaritë investuese			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	9	(806,683)	(1,456,776)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		597,518	-
Flukset neto të parasë (përdorur në)/gjeneruar nga veprimtaritë investuese		(209,165)	(1,456,776)
Flukset e parasë nga veprimtaritë financuese			
Hua të paguara	20	-	(126,249,998)
Shlyerja e detyrimeve të qirasë		(11,641,965)	-
Flukset neto të parasë përdorur në veprimtaritë financuese		(11,641,965)	(126,249,998)
Rritja/(ulja) neto e mjeteve monetare dhe ekuivalente me to		(7,140,396)	(197,328,453)
Mjetet monetare dhe ekuivalente me to më 1 janar		15,920,521	213,248,974
Efekt i ndryshimeve të kursit të këmbimit në mjete monetare dhe ekuivalente me to		(222,661)	-
Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 dhjetor	14	8,557,464	15,920,521

Shënimet në faqet 5 deri në 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

British American Tobacco – Albania Shpk **Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

1. Entiteti raportues

British American Tobacco – Albania Shpk (“Shoqëria”) u themelua si një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në Tiranë më 15 tetor 2001. Shoqëria zotërohet plotësisht nga British American Tobacco International Holdings B.V. e bazuar në Hollandë. Shoqëria mëmë përfundimtare e Shoqërisë është British American Tobacco plc. (ose “Grupi”), e vendosur në Londër, Mbretëria e Bashkuar.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është importi dhe shitja me shumicë e pakicë e cigareve dhe produkteve të tjera të duhanit me markën e British American Tobacco, në Shqipëri. Shoqëria operon në kuadër të strategjisë dhe objektivave të Grupit për Shqipërinë dhe rajonin e Ballkanit duke përfshirë Kosovën dhe Maqedoninë. Furnitorët dhe financuesit kryesorë të Shoqërisë janë Shoqëri brenda Grupit (shih shënimin 29). Zyra e regjistruar e Shoqërisë ndodhet në Rrugën e Kavajës, Ish Kombinati Ushqimor, Tiranë, Shqipëri.

2. Bazat e kontabilitetit

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”). Këto janë pasqyrat e para vjetore të Shoqërisë në të cilat është zbatuar SNRF 16 Qiratë. Ndryshimet në politikat e rëndësishme kontabël përshkruhen në Shënimin 6.

3. Baza e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

4. Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në lek Shqiptar (“Lek”), e cila është edhe monedha funksionale e Shoqërisë.

5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, çmuarje dhe supozime, të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime. Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën çmuarja rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

Informacioni mbi pasiguritë lidhur me çmuarjet dhe gjykimet të cilat kanë risk të rëndësishëm për të rezultuar në një rregullim material në pasqyrat financiare, është përshkruar në paragrafin e mëposhtën si dhe jepen në shënimet e mëposhtme:

A. Gjykime

Shënimi 7(c) – Inventari i cili kërkon gjykim në vlerësimin e vlerës së tyre të drejtë kur çmohet vlera neto e realizueshme.

Shënimi 7(e) – Të arkëtueshmet tregtare të cilat kërkojnë gjykim për vlerësimin e fondit për borxhin e keq.

Shënimi 7(h) – Njohja e të ardhurave: nëse të ardhurat do të njihen në një moment të caktuar kohor apo përgjatë periudhës.

B. Supozimet dhe paqartësitë e vlerësimit

Shënimi 7(i) – Njohja e të ardhurave: Vlerësimi i kthimeve të pritura.

Shënimi 7(e) – Matja e zbritjes për Humbje të Pritshme Kreditore (HPK-ve) për të arkëtueshmet tregtare.

Shënimi 7(g) – njohjen dhe matjen e provigjoneve dhe detyrimeve të mundshme: supozimet kryesore rreth gjasave dhe madhësisë së një rrjedhje të burimeve.

Shënim 7 (h) - Afati i qirasë: nëse Shoqëria ka siguri të arsyeshme për të ushtruar opsionin për të zgjatur periudhën e qirasë.

6. Ndryshime në politikat e rëndësishme kontabël

Shoqëria ka zbatuar për herë të parë SNRF 16 “Qiratë” nga 1 janari 2019. Një numër standardesh të reja janë bërë efektive duke filluar nga 1 janari 2019, por nuk kanë pasur ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Shoqëria ka zbatuar SNRF 16 duke përdorur qasjen e modifikuar retrospektive, sipas së cilës zbatimi fillestar nuk ka efekt kumulativ në fitimet e pashpërndara më 1 janar 2019. Rrjedhimisht, informacioni krahasues i paraqitur për vitin 2018 nuk është rivlerësuar, pra ai paraqitet, siç është raportuar më parë, sipas SNK 17 dhe interpretimeve përkatëse. Detajet e ndryshimeve në politikat kontabël janë shpalosur më poshtë.

British American Tobacco – Albania Shpk
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

6. Ndryshime në politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

Për më tepër, kërkesat në lidhje me dhënien e informacioneve shpjeguese sipas SNRF 16 në përgjithësi nuk janë zbatuar për informacionin krahasues.

A. Përcaktimi i qirasë

Më parë, Shoqëria përcaktonte në fillim të kontratës nëse një marrëveshje ishte ose përmbante një qira sipas KIRFN 4 “Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një Qira”. Shoqëria tani vlerëson nëse një marrëveshje përmban një qira bazuar në përkufizimin e qirasë, siç shpjegohet në Shënimin 7 (h).

Shoqëria zbatoi SNRF 16 vetëm mbi kontratat që ishin identifikuar më parë si qira. Kontratat, të cilat nuk përmbanin një qira sipas SNK 17 dhe KIRFN 17, nuk u rivlerësuan nëse identifikonin një të tillë sipas SNRF 16. Prandaj, përkufizimi i qirasë sipas SNRF 16 u zbatua vetëm mbi kontratat e lidhura apo të ndryshuara në ose pas datës 1 janar 2019.

B. Si qiramarrës

Si qiramarrës, Shoqëria merr me qira ambientet e saj të zyrës dhe magazinave, si dhe automjete transporti. Shoqëria më parë klasifikonte qiratë në qira operative ose financiare bazuar në vlerësimin e saj nëse qiraja transferonte në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe shpërblimet në pronësi të aktivitetit themelor në Shoqëri. Sipas SNRF 16, Shoqëria njeh aktivitetet me të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë për shumicën e këtyre qirave - d.m.th. këto qira janë në pasqyrën e pozicionit financiar.

Me fillimin ose me modifikimin e një kontrate që përmban një komponent të qirasë, Shoqëria jep vlerësimin në kontratë për secilin komponent të qirasë në bazë të çmimit të tij të pavarur relativ. Sidoqoftë, për qiratë e ndërtesave, Shoqëria ka zgjedhur të mos ndajë komponentët jo-qira dhe të kontabilizojë për qiranë dhe komponentët e lidhur me të, si një komponent i vetëm i qirasë.

C. Ndikimi në pasqyrat financiare

Ndikimi në tranzicion

Me kalimin në SNRF 16, Shoqëria njohu aktivitetet me të drejtë përdorimi në një shumë të barabartë me detyrimet e qirasë. Ndikimi në tranzicion është përmbledhur më poshtë.

Në Lek	1 janar 2019
Aktive me të drejtë përdorimi – Ndërtesa	22,304,802
Aktive me të drejtë përdorimi – Automjete	-
Detyrimet e qirasë	(22,304,802)

Për matjen e detyrimeve të qirasë që kanë qenë klasifikuar si qira operative, Shoqëria skontoi pagesat me normën rritëse të huamarrjes më 1 janar 2019. Norma mesatare e aplikuar është 4.47%.

Në Lek	1 janar 2019
Angazhimet e qirasë operative në 31 dhjetor 2018 siç shpaloset nën SNK 17 në pasqyrat financiare të Shoqërisë	4,640,592
Te skontuara me normën rritëse të huasë më 1 janar 2019	4,587,246
Shtesa për shkak të opsioneve të zgjatjes	17,717,556
Përrjashtime nga njohja për qiratë e pasurive me vlerë të ulët	-
Përrjashtime nga njohja për qira me më pak se 12 muaj qira, në tranzicion	-
Detyrimet e qirasë të njohura më 1 janar 2019	22,304,802

Për ndikimin e SNRF 16 në fitim ose humbje dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin, shih Shënimin 10 (b). Për detajet e politikave të kontabilitetit sipas SNRF 16 dhe SNK 17, shih Shënimin 7 (h).

British American Tobacco – Albania Shpk
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

7. Përmbledhja e politikave kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të njëjtë në të gjithë periudhat të paraqitura në këto pasqyra financiare, përveçse nëse përmendet ndryshe (shih Shënimin 6).

a) Konvertimi i monedhave të huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare të mbajtura në monedhë të huaj në datën e raportimit, konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportit. Fitimet ose humbjet nga shlyerja e transaksioneve në monedhë të huaj si dhe nga konvertimi aktiveve dhe detyrimeve monetare në monedhë të huaj me kursin e fundit të vitit, njihen në fitim ose humbje.

b) Aktivet afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale (pajisjet) mbahen me kosto historike minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë, nëse ka të tilla. Kosto historike përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostot e mëpasshme përfshihen në vlerën kontabël të aktivitet afatgjatë material ose njihen si aktiv më vete vetëm nëse është e mundshme që Shoqëria të ketë përfitime të ardhshme ekonomike të lidhura me aktivin në fjalë dhe kostoja e tij të mund të matet në mënyrë të besueshme. Të gjithë shpenzimet e tjera të mirëmbajtjeve dhe riparimeve njihen në fitim ose humbje në momentin që ato ndodhin.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale njihen neto në zërin ‘Të ardhura të tjera operationale’ në fitim ose humbje.

Zhvlerësimi përlogaritet për të zvogëluar koston e aktiveve afatgjata materiale minus vlerën e tyre të mbetur, duke përdorur metodën lineare përgjatë jetës së tyre të dobishme, dhe përgjithësisht njihet në fitim ose humbje. Zhvlerësimi fillon të njihet në muajin pas atij të blerjes. Jetët e dobishme të vlerësuara janë si në vijim:

Përshkrimi i kategorisë	Vitet
Pajisje zyre dhe mobilje	5
Pajisje IT	4
Mjete transporti	5

Jeta e dobishme dhe vlera e mbetur e aktivitet rishikohen dhe nëse është e nevojshme, rregullohen në çdo datë raportimi.

c) Inventarët

Inventarët maten me vlerën më të ulët mes koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e inventarëve llogaritet me metodën FIFO (first-in, first-out) dhe përfshin koston e blerjes, taksa e detyrime të pa rimbursueshme dhe kosto të tjera të kryera për sjelljen e tyre në vendin dhe gjendjen e gatshme për përdorim. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes gjatë rrjedhës së zakonshme të biznesit, minus koston e vlerësuar të përfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

d) Instrumentet financiarë

Shoqëria zotëron vetëm instrumente financiarë jo derivative.

(i) Aktivitet dhe detyrimet financiare jo derivativë – Klasifikimi dhe matja

Në njohjen fillestare, një aktiv financiar klasifikohet si i matur me: koston e amortizuar; VDATGj - investim në instrumente borxhi; VDATGj - investim në instrumente të kapitalit neto; ose VDPFH.

Aktivitet financiarë nuk riklasifikohen pas njohjes së tyre fillestare, përjashtuar rastin kur Shoqëria ndryshon modelin e saj të biznesit për drejtimin e aktiveve financiare, rast kur riklasifikohen të gjitha aktivitet e ndikuara.

Në njohjen fillestare të një investimi në instrumente të kapitalit neto që nuk mbahet për shitje, Shoqëria mund të zgjedhë në mënyrë të pakthyeshme për të paraqitur ndryshimet e mëvonshme në vlerën e drejtë të investimit në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse (ATGj). Ky vendim merret individualisht për çdo investim.

7. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)

d) Instrumentet financiarë (vazhdim)

i) Aktivet dhe detyrimet financiare jo derivativë – Klasifikimi dhe matja (vazhdim)

Shoqëria bën një vlerësim të objektivit të modelit të biznesit në të cilin një aktiv mbahet në nivel portofoli pasi kjo reflekton më së miri mënyrën se si drejtohet biznesi dhe informacionin që i ofrohet drejtimit. Informacioni përfshin:

Aktivitet financiarë - Vlerësimi i modelit të biznesit: politikat dhe objektivat e deklaruara për portofolin dhe funksionimi i këtyre politikave në praktikë. Këtu përfshihet nëse strategjia e drejtimit përqendrohet në fitimin e flukseve monetare kontraktuale, duke përputhur kohëzgjatjen e aktiveve financiare me kohëzgjatjen e ndonjë detyrimi të lidhur ose daljen e flukseve monetare ose duke realizuar flukset e mjeteve monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve;

- si vlerësohet performanca e portofolit dhe si i raportohet drejtimit të Shoqërisë
- rreziqet që ndikojnë performancën e modelit të biznesit (dhe aktivitet financiarë të mbajtura në këtë model biznesi) dhe si menaxhohen rreziqet.
- frekuenca, sasia dhe koha e shitjes së aktiveve financiare në periudha të mëparshme, arsyet e shitjeve dhe pritshmëritë për aktivitetin e ardhshëm të shitjes

Shoqëria fillimisht njihet huatë dhe të arkëtueshmet në datën kur ato krijohen. Të gjithë aktivitet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, kur Shoqëria bëhet palë kontraktuale e një instrument.

Shoqëria çregjistron aktivitet financiarë nëse të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose nëse Shoqëria i transferon të drejtat për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale nga aktivi financiar një pale tjetër, duke transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin. Çdo interes në aktivitet financiarë të transferuara që përfitohet ose mbahet nga Shoqëria njihet si një aktiv ose detyrim më vete

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo përfunduar.

Aktivitet dhe detyrimet financiarë netohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pozicionin financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto të drejtpërdrejtë të transaksionit. Pas njohjes fillestare, ato mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus humbjet nga zhvlerësimi (shih shënimin 7(e)(i)).

Detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë minus çdo kosto të drejtpërdrejtë të transaksionit. Pas njohjes fillestare, këto detyrime mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Kontabilizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare është paraqitur në politikën kontabël 7 (k).

e) Zhvlerësimi

(i) Aktive financiare

Shoqëria njihet zbritje për humbjet e pritshme kreditore (HPK) për aktivitet financiarë të matura me koston e amortizuar. Zbritja e humbjeve për zhvlerësimin e të arkëtueshmeve tregtare maten gjithmonë me vlerën e barabartë me humbjet e pritshme kreditore përgjatë gjithë jetës së aktivitet. Gjatë vlerësimit nëse rreziku kreditor i një aktivi financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare dhe gjatë vlerësimit të humbjes së pritshme kreditore, Shoqëria konsideron informacione të arsyeshme të cilat janë të disponueshme pa kosto apo përpjekje të tepërta. Kjo përfshin informacionin cilësor dhe sasior, bazuar në përvojën historike të Shoqërisë, vlerësimin e kredisë dhe informacionin për të ardhmen.

British American Tobacco – Albania Shpk **Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

7. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)

e) Zhvlerësimi (vazhdim)

Matja e HPK-ve

HPK-të janë vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve kreditore. Humbjet kreditore janë vlera aktuale e diferencave në flukset monetare (d.m.th diferenca mes flukseve monetare kontraktuale dhe mjeteve monetare që Shoqëria pret të arkëtojë).

Drejtimi ka përdorur lehtësinë praktike të zbatimit të matricave të provizioneve për të matur humbjet e pritshme kreditore përgjatë gjithë jetës të llogarive të arkëtueshme që vlerësohen në baza kolektive.

Për llogaritë e arkëtueshme që vlerësohen individualisht, drejtimi vlerëson shumën e rikuperueshme duke përdorur metoda të ndryshme, në varësi mënyrës se si pritet të rikuperohen shumat e arkëtueshme, si p.sh.:

- shumat e rikuperueshme sipas një skenari hipotetik likuiditeti;
- shumat e skontuar të shitjes sipas metodës fluks monetar/shërbimi i borxhit;
- normat e rregulluara të provizionit (duke iu referuar normave të provizionit të përdorura për vlerësim kolektiv duke bërë përshtatje bazuar në skenarë specifikë si p.sh. kontratat me elementë të rëndësishëm të financimit).

Paraqitja e zbritjes për HPK-të në pasqyrën e pozicionit financiar

Zbritjet për HPK-të nga aktivet financiare të matura me kosto të amortizuara i zbriten vlerës kontabël bruto të aktiveve. Për letrat me vlerë të borxhit me VDATGj, humbja kreditore kalon në fitimin ose humbjen e periudhës dhe njihet në ATGj.

Fshirja

Vlera kontabël bruto e një aktivi financiar fshihet kur Shoqëria nuk ka pritshmëri për rikuperimin e plotë ose të pjesshëm të tij. Shoqëria nuk pret rikuperim të konsiderueshëm nga shumat e fshirë. Megjithatë, aktivet financiare të çregjistruara mund të mbeten objekt i aktiviteteve përmbarimore për të qenë në përputhje me procedurat e Shoqërisë për rikuperimin e shumave për t'u arkëtuar.

(ii) Aktivet jo-financiare

Vlerat kontabël të aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarëve dhe aktiveve tatimore të shtyra, rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Nëse ka tregues të tillë, atëherë çmohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose njësie gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së tij të drejtë minus kostot për t'u shitur. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare skontojnë për të dhënë vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të aktivit. Me qëllim testimit për zhvlerësim, aktivet grupohen së bashku në njësinë më të vogël të aktiveve që gjenerojnë flukse hyrëse monetare nga përdorimi i vazhdueshëm që janë të pavarura nga flukset hyrëse monetare të aktiveve të tjera apo grupeve të tjera të aktiveve ("njësi gjeneruese e mjeteve monetare"). Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbartur e një aktivi ose e një njësie gjeneruese të mjeteve monetare e tejkalon shumën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në lidhje me një njësi gjeneruese të mjeteve monetare shpërndahen për të zvogëluar vlerën e mbartur të aktiveve në njësi (grup njësis) në varësi të peshës së secilit. Humbja nga zhvlerësimi rishikohet në çdo datë raportimi për tregues që humbja është pakësuar ose nuk ekziston më. Humbja nga zhvlerësimi rimerret nëse ka patur një ndryshim në vlerësimin e përdorur për të përcaktuar vlerën e realizueshme. Humbja nga zhvlerësimi kthehet vetëm në masën në të cilën vlera e mbartur e aktivit nuk tejkalon vlerën e mbetur të tij, që përcaktohet nga vlera neto e tij pas amortizimit, nëse nuk ka humbje nga zhvlerësimi.

f) Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale.

g) Provizionet

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të kaluara, që mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të kërkohet një fluks dalës të mirash ekonomike për të shlyer detyrimin. Provizionet llogariten duke skontuar flukset e ardhshme monetare më një normë përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Amortizimi kohor i skontimit njihet si kosto financiare.

7. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)

h) Qiratë

Politika e zbatueshme nga 1 janari 2019

Në lidhjen e një kontrate, Shoqëria përcakton nëse kontrata është ose përmban një kontratë qiraje. Një kontratë është ose përmban një kontratë qiraje, nëse jep të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar për një periudhë kohore të përcaktuar në këmbim të pagesës së një shume. Për të vlerësuar nëse një kontratë e caktuar i jep të drejtën për të përdorur një aktiv të identifikuar, Shoqëria përdor përkufizimin e qirasë sipas SNRF 16. Kjo politikë është zbatuar mbi kontratat e lidhura në dhe pas datës 1 janar 2019.

i) Si qiramarrës

Në momentin e lidhjes apo modifikimit të një kontrate që përmban një qira, Shoqëria përcakton shumën në kontratë të ndarë për secilin përbërës së qirasë mbi bazën e çmimit relativ përkatës të tij. Sidoqoftë, për qiratë e ndërtesave, Shoqëria ka vendosur që të kombinojë përbërësit jo-qira me përbërësit qira dhe t'i trajtojë ato si një përbërës i vetëm i qirasë.

Shoqëria njeh një aktiv me të drejtë përdorimi dhe një detyrim për qiranë në datën e fillimit të qirasë. Aktivi me të drejtë përdorimi matet fillimisht me koston e tij, që përmban shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë të rregulluar me çdo pagesë të qirasë të bërë para ose në datën e fillimit, plus çdo kosto fillestare të drejtpërdrejtë të kryer dhe një vlerësim të kostove që do të ndodhin për çmontimin dhe lëvizjen e aktivitet bazë, restaurimin e aktivitet apo vendit në të cilin është vendosur aktivi, minus çdo stimul qiraje të marrë.

Aktivi me të drejtë përdorimi amortizohet nëpërmjet metodës lineare nga dita e fillimit të qirasë deri në fund të afatit të qirasë, përveç nëse qiradhënësi transferon pronësinë e aktivitet bazë tek Shoqëria në përfundim të afatit të qirasë ose nëse kostoja e aktivitet me të drejtë përdorimi reflekton se Shoqëria do të ushtrojë një opsioni blerjeje. Në këtë rast, aktivi me të drejtë përdorimi do të amortizohet përgjatë jetës së dobishme të aktivitet bazë, që përcaktohet mbi të njëjtat baza si për aktivet afatgjata materiale.

Gjithashtu, vlera e aktivitet me të drejtë përdorimi ulet periodikisht me humbjen nga zhvlerësimi, nëse ka, dhe rregullohet me vlerën e ndonjë ri-matjeje të caktuara për detyrimin e qirasë.

Detyrimi për qiranë njihet fillimisht me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që nuk janë paguar ende në atë datë, të skontuara me normën e interesit të përcaktuar të qirasë. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtë, do të përdoret norma rritëse e huamarrjes e Shoqërisë. Përgjithësisht, Shoqëria përdor normën rritëse të huamarrjes për të skontuar pagesat e qirasë.

Shoqëria përcakton normën rritëse të huamarrjes duke marrë norma interesi nga burime të ndryshme të jashtme financimi dhe duke bërë rregullime të ndryshme për të reflektuar termat e qirasë dhe llojin e aktivitet të marrë me qira.

Pagesat e qirasë që përfshihen në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga elementët më poshtë:

- pagesat fikse, duke përfshirë këtu dhe pagesat fikse në-thelb,
- pagesat variabël të qirasë, të cilat varen nga një indeks ose normë, që maten fillimisht duke përdorur një indeks ose normë në datën e fillimit,
- shumat e pritshme për t'u paguar sipas vlerës së mbetur të garancisë, dhe
- çmimi i ushtrimit të një opsioni blerjeje nëse Shoqëria ka siguri të arsyeshme për ta ushtruar atë opsion, pagesat e qirasë për një periudhë rinovimi opsionale nëse Shoqëria ka siguri të arsyeshme për të ushtruar opsionin e zgjatjes së afatit të qirasë dhe pagesat e gjobave për përfundimin e parakohshëm të qirasë, përveç nëse Shoqëria ka siguri të arsyeshme që nuk do të përfundojë kontratën para kohe.

Detyrimi i qirasë matet me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Rivlerësohet kur ka një ndryshim në pagesat e qirasë në të ardhmen që vijnë nga një ndryshim në një indeks ose normë, nëse ka një ndryshim në vlerësimin e Shoqërisë për shumën që pritët të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur, nëse Shoqëria ndryshon vlerësimin e saj nëse ajo do të ushtrojë një mundësi blerjeje, zgjatjeje ose përfundimi ose nëse ka një pagesë të rishikuar të qirasë fikse. Kur detyrimi për qiranë rimatet në këtë mënyrë, bëhet një rregullim përkatës në vlerën kontabël neto të aktivitet me të drejtë përdorimi ose regjistrohet ndryshimi në fitim ose humbje e vitit nëse vlera e aktivitet me të drejtë përdorimi zvogëlohet në zero.

7. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)

h) Qiratë (vazhdim)

Qiratë afatshkurtra dhe qiratë e aktiveve me vlerë të ulët

Shoqëria ka vendosur të mos njohë aktive me të drejtë përdorimi dhe detyrime për qira për qiratë me vlerë të ulët të aktivitetit dhe qiratë afatshkurtra, duke përfshirë pajisjet informatike. Shoqëria njeh pagesat e qirasë për këto qira si shpenzim mbi bazë lineare përgjatë afatit të qirasë.

Politika e zbatueshme përpara 1 janarit 2019

Si qiramarrës

Në periudhën krahasuese, si qiramarrëse, Shoqëria i klasifikonte qiratë, të cilat transferonin në mënyrë të konsiderueshme rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, si qira financiare. Në të tilla raste, aktivet e marra me qira mateshin fillimisht me vlerën më të ulët midis vlerës së drejtë dhe vlerës aktuale të pagesave minimale të qirasë. Pagesat minimale të qirasë ishin pagesat që qiramarrësi detyrohej të kryente përgjatë afatit të qiramarrjes, duke përjashtuar qiratë eventuale. Pas njohjes fillestare, aktivet llogariteshin në përputhje me politikën kontabël të aplikueshme për atë aktiv.

Aktivitetet e mbajtura si qira të tjera, klasifikoheshin si qira operative dhe nuk njiheshin në pasqyrën e pozicionit financiar të Shoqërisë. Pagesat e kryera për qiratë operative njiheshin në fitim ose humbjen e vitit mbi një bazë lineare mbi afatin e qirasë. Stimujt e marrë për qiratë njiheshin si pjesë integrale e shpenzimeve totale për qiratë përgjatë afatit të qirasë.

i) Të ardhurat

Tabela në vijim jep informacion në lidhje me natyrën dhe kohën e përmbushjes së detyrimeve të performancës në kontratat me klientët, duke përfshirë kushtet të rëndësishme të pagesave dhe politikat e njohjes së të ardhurave.

Tipi i produktit	Natyra dhe koha e përmbushjes së kushteve të performancës, detyrimet, përfshirë kushtet e rëndësishme të pagesave	Njohja e të ardhurave sipas SNRF 15
Cigare	<p>Klienti merr kontrollin e produkteve kur mallrat janë dorëzuar dhe janë pranuar në ambientet e tyre. Faturat gjenerohen në atë moment. Faturat zakonisht paguhen brenda 40 ditëve. Nuk ka zbritje për produktet.</p> <p>Kontrata lejon klientin të kthejë një artikull.</p>	<p>Të ardhurat njihen kur mallrat janë dorëzuar dhe janë pranuar nga klienti në ambientet e tij.</p> <p>Të ardhurat njihen në masën që ka një probabilitet të madh që nuk do të ndodhë një kthim i konsiderueshëm në shumën e të ardhurave kumulative të njohura.</p> <p>Prandaj, shumat e të ardhurave të njohura rregullohet për kthimet e pritshme, të cilat vlerësohen bazuar në të dhënat historike për lloje të veçanta të produkteve.</p>

j) Përfitimet e punonjësve

Skemë me kontribute të përcaktuara

Shoqëria paguan kontribute fikse për sigurimet Shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve të saj mbi daljen në pension. Detyrimet për kontribute në skemat e pensioneve me kontribute të përcaktuara njihen si shpenzim në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet, në bazë të një plani kontributesh të përcaktuara.

7. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)

j) Përfitimet e punonjësve (vazhdim)

Përfitimet afatshkurtra

Detyrimet për përfitimet afatshkurtra të punonjësve vlerësohen të paskontuara dhe njihen si shpenzim kur shërbimi përkatës kryhet. Një detyrim njihet për shumën që pritet të paguhet sipas përfitimeve afatshkurtra apo planeve për ndarjen e fitimit, nëse Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të shkuara, të kryera nga punonjësi dhe detyrimi mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

k) Të ardhurat dhe kostot financiare

Të ardhurat financiare dhe kostot financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi, shpenzimet e interesit dhe fitimet ose humbjet nga veprimet në monedhë të huaj. Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në fitim ose humbje, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga këmbimi në monedha të huaja paraqiten për shumën neto.

l) Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale dhe tatimi i shtyrë njihen në fitim ose humbje, përveçse kur lidhen me elementë që njihen drejtpërdrejt në kapital ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

(i) Tatim fitim aktual

Tatimi i periudhës aktuale është tatimi i pritshëm për t'u paguar ose për t'u arkëtuar nga të ardhurat e tatueshme ose humbja për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose të cilat hyjnë në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullimi të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferenca të përkohshme ndërmjet vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerat e përdorura për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen mbi diferencat e përkohshme kur të kthehen, në bazë të ligjeve në fuqi ose të cilat hyjnë në fuqi e raportimit financiar.

Aktivet për tatime të shtyra njihen vetëm deri në masën që është e mundur që të kenë fitime të tatueshme në të ardhmen, kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Tatimi i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet në masën që nuk është më e mundur që përfitimi tatimor të realizohet.

Aktivet dhe detyrimet e shtyra tatimore paraqiten neto, në qoftë se ka një të drejtë ligjore për të netuar aktivet dhe detyrimet aktuale tatimore, dhe ato lidhen me tatime mbi të ardhurat të vendosura nga i njëjti autoritet tatimor, për të njëjtin subjekt tatimor, ose mbi subjekte të ndryshme tatimore, por ata kanë për qëllim të shlyejnë detyrimet dhe aktivet aktuale tatimore në bazë neto, ose aktivet dhe detyrimet tatimore do të realizohen në të njëjtën kohë.

Në përcaktimin e vlerës së tatim fitimit aktual dhe të shtyrë Shoqëria merr parasysh impaktin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse taksa dhe interesa shtesë mund të jenë të pagueshme. Shoqëria beson se përlllogaritjet për detyrime tatimore janë të përshtatshme për të gjitha vitet, bazuar në vlerësimin e shumë faktorëve, duke përfshirë interpretime të ligjit të taksave dhe eksperiencës së mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në llogaritje dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh rreth ngjarjeve të ardhshme. Informacion i ri mund të jetë në dispozicion dhe mund të shkaktojë që Shoqëria të ndryshojë gjykimet në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshime të tilla në detyrimet tatimore do të kenë impakt mbi tatim fitimin në periudhat që ky përcaktim bëhet.

7. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)

m) Standardet dhe interpretimet e reja ende të pa-adoptuara

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja, ndryshimet e standardeve ekzistuese dhe interpretimet e reja të mëposhtme ishin të publikuara por ende jo efektive. Shoqëria nuk ka adoptuar asnjë nga standardet, ndryshimet dhe interpretimet e publikuara por ende jo efektive.

Standardet dhe interpretimet e reja apo të ndryshuara nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

- **SNRF 17 “Kontratat e Sigurimit”** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021),
- **Ndryshime në SNRF 3 “Kombinimet e Biznesit”** - Përkufizimi i një biznesi (efektive për kombinimet e bizneseve, për të cilat data e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së parë të raportimit periodik që fillon në ose pas 1 janarit 2020 dhe për blerjen e aktiveve që ndodhin në dhe pas fillimit të asaj periudhe),
- **Ndryshime në SNRF 9 “Instrumentet Financiarë”, SNK 39 “Instrumentet Financiarë: Njohja dhe Matja” dhe SNRF 7 “Instrumentet Financiarë: Dhënie Informacionesh Shpjeguese”** - Reforma referuese për normat e interesit (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020),
- **Ndryshime në SNRF 10 “Pasqyrat Financiare të Konsoliduara” dhe SNK 28 “Investime në Pjesëmarrje”**- Shitja ose Kontributi i një aktiveve midis një Investitori dhe një Pjesëmarrësi ose Shoqërie të Përbashkët, së bashku me ndryshime të tjera (data efektive është shtyrë pa afat deri në përfundimin e projektit kërkimor mbi metodat e kapitalit neto),
- **Ndryshime në SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare” dhe SNK 8 “Politikat Kontabël, Ndryshime në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet”**- Përkufizimi i materialitetit (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020),
- **Ndryshime në SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”** – Klasifikimi i Detyrimeve si Afatshkurtra dhe Afatgjata (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022),
- **Ndryshimet në referencat e Kuadrit Konceptual për standardet SNRF** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).

8. Instrumentet financiare – vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut

(a) Vlera e drejtë

Disa nga politikat kontabël dhe shpalosje të Shoqërisë kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo-financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllime të matjes dhe/ose shpalosjes duke u bazuar në metodat e mëposhtme. Aty ku është e zbatueshme, informacion i mëtejshëm në lidhje me supozimet e bëra në përcaktimin e vlerave të drejta është shpalosur në shënimet shpjeguese specifike për aktivet ose detyrimet .

Aktivitet financiar jo derivativë

Llogaritë e arkëtueshme tregtare paraqiten neto nga zhvlerësimi. Llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë kanë një vlerë të drejtë e cila përaftron me vlerën e tyre të mbetur për shkak të natyrës afatshkurtër të tyre.

Detyrime financiare jo-derivativë

Vlera e drejtë, e cila është përcaktuar për qëllime prezantimi, është llogaritur bazuar në vlerën aktuale të flukseve monetare të ardhshme të principalit dhe të interesit, të aktualizuara me normën e tregut të interesit në datën e raportimit. Vlera kontabël e huave dhe detyrimeve të tjera përaftron me vlerën e tyre të drejtë për shkak të afatit të tyre të shkurtër të maturimit.

(b) Administrimi i rrezikut financiar

Administrimi i rrezikut financiar është element thelbësor në aktivitetin e Shoqërisë. Rreziqet më të mëdha ndaj të cilave Shoqëria është e ekspozuar janë si në vijim:

- rreziku kreditor
- rreziku i likuiditetit; dhe
- rreziku i tregut.

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqërisë për matjen dhe administrimin e rrezikut dhe administrimin e kapitalit.

(i) Kuadri i administrimit të rrezikut

Politikat e administrimit të rrezikut të Shoqërisë kanë për qëllim të identifikojnë, analizojnë dhe menaxhojnë rrezikun me të cilin përballet Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e duhura për rreziqet, dhe monitoruar vazhdimisht nivelet e rrezikut dhe përputhshmërinë me limitet. Politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara dhe dhe praktikat më të mira në zhvillim.

Drejtimi i Shoqërisë në bashkëpunim me strukturat e administrimit të rrezikut të grupit dhe të mbikëqyrur nga grupi, ka përgjegjësi mbi mbikëqyrjen e kuadrit të administrimit të rrezikut, duke mbikëqyrur administrimin e rreziqeve kryesore, duke rishikuar politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut si dhe duke aprovuar transaksionet që përfshijnë shuma të rëndësishme.

Funksioni i administrimit të rrezikut brenda Shoqërisë i referohet administrimit të rrezikut financiar, rrezikut operacional dhe rrezikut ligjor.

Rreziku financiar përfshin rrezikun e tregut (duke përfshirë rrezikun e monedhës, rrezikun e normës së interesit dhe rreziqe të tjera të çmimeve), rrezikun kreditor dhe rrezikun e likuiditetit. Objektivat kryesore të administrimit të rrezikut financiar janë përcaktimi i limiteve të rrezikut, dhe të sigurojë që ekspozimi ndaj rreziqeve të jetë brenda këtyre limiteve. Administrimi i rrezikut operacional dhe rrezikut ligjor synojnë të sigurojnë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme, për të minimizuar rreziqet operationale dhe ligjore.

Faktorët e rrezikut të jashtëm dhe të brendshëm identifikohen dhe administrohen përmes strukturës organizative të Shoqërisë dhe veçanërisht nga strukturat e administrimit të rrezikut në nivel grupi.

British American Tobacco – Albania Shpk
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

8. Instrumentet financiare – vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)

(b) Administrimi i rrezikut financiar(vazhdim)

(ii) Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare të Shoqërisë nëse një klient ose një palë e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e saj kontraktuale dhe lind kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë. Klienti i vetëm i Shoqërisë (“Klienti”), është një Shoqëri vendase e shitjes me shumicë. Ekspozimi i Shoqërisë kundrejt rrezikut kreditor ndikohet kryesisht nga karakteristikat individuale të Klientit të saj.

Pas datës së raportimit, Shoqëria ka arkëtuar të gjithë shumën e mbetur të llogarive të arkëtueshme tregtare dhe nuk pret ndonjë humbje nga mospagimi. Klienti ka ofruar një garanci bankare prej 2,750,000 Euro, e vlefshme deri më 31 dhjetor 2020, për të garantuar të arkëtueshmet. Sipas kontratës midis palëve, kjo garanci do të jetë në fuqi përgjatë gjithë periudhës së kontratës. Gjithashtu, të arkëtueshmet e mbetura janë mbuluar me barrë siguroese në favor të Shoqërisë mbi inventarin e cigareve gjendje të mbajtur nga Klienti. Më 31 dhjetor 2019, stoku i cigareve i mbajtur nga Klienti, i matur me çmimin e shitjes, të faturuar nga Shoqëria, është 89,825 mijë Lekë (2018: 161,336 mijë Lekë).

Ekspozimi maksimal i Shoqërisë ndaj rrezikut kreditor reflektohet në vlerën kontabël të aktiveve.

	2019	2018
Të arkëtueshme tregtare (Shënimi 12)	229,792,785	350,619,077
Të arkëtueshme të tjera (Shënimi 13)	41,678,241	35,423,866
Mjete monetare dhe ekuivalente me to (Shënimi 14)	8,557,464	15,920,521
	280,028,490	401,963,464

Më 31 dhjetor 2019 dhe 2018, analiza e vjetërsisë së të arkëtueshmeve është si në vijim:

	2019	2018
Pa vonesë dhe jo të zhvlerësuara	267,005,070	385,603,454
Zbritje për zhvlerësim	(34,791,575)	(34,791,575)
Zbritje për humbjet e pritshme kreditore	(2,420,710)	(192,802)
	229,792,785	350,619,077

Nuk ka lëvizje në zbritjen për zhvlerësimin lidhur me mallra të dëmtuara të furnizuara tek Klienti në shumën prej 34,791,575 Lekë gjatë vitit 2019 dhe 2018.

(iii) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria nuk do të përmbushë obligimet e saj që lidhen me detyrime financiare brenda periudhës kur duhet të shlyhen. Përfaqja e Shoqërisë për të menaxhuar likuiditetin është të sigurojë, sa më shumë që të jetë e mundur, që do të ketë gjithmonë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj kur ato maturohen, në kushte normale dhe të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme ose rrezikuar reputacionin e saj.

Zakonisht Shoqëria sigurohet se ka likuiditet të mjaftueshëm për të përballuar shpenzimet e pritshme operacionale, duke përfshirë shlyerjen e detyrimeve financiare; kjo përjashton ndikimin potencial të rrethanave ekstreme që nuk mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, të tilla si katastrofat natyrore.

Struktura e maturitetit të detyrimeve financiare të Shoqërisë në bazën e pagesave kontraktuale të paskontuara është prezantuar si më poshtë:

31 dhjetor 2019	Më pak se 3 muaj	Midis 3 muaj dhe 1 vit	Totali
Detyrimet financiare			
Huatë	1,407,176	83,394,655	84,801,831
Të pagueshme tregtare	116,157,647	-	116,157,647
Të pagueshme ndaj personelit dhe shpenzime të llogaritura (shënimi 16)	157,795,536	-	157,795,536
Totali i detyrimeve financiare	275,360,359	83,394,655	358,755,014

British American Tobacco – Albania Shpk
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

8. Instrumentet financiare – vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)
(b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)
(iii) Rreziku i Likuiditetit (vazhdim)

31 dhjetor 2018	Më pak se 3 muaj	Midis 3 muaj dhe 1 vit	Totali
Detyrimet financiare			
Huatë	1,460,333	84,528,098	85,988,431
Të pagueshme tregtare	152,230,440	-	152,230,440
Të pagueshme ndaj personelit dhe shpenzime të llogaritura (shënimi 16)	94,289,330	-	94,289,330
Totali i detyrimeve financiare	247,980,103	84,528,098	332,508,201

(iv) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që lëvizjet në çmimet e tregut, duke përfshirë edhe kurset e këmbimit dhe normat e interesit, do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqërisë. Rreziku i tregut përfshin rrezikun e monedhës dhe rrezikun e normës së interesit, meqenëse Shoqëria nuk është e ekspozuar ndaj instrumenteve të kapitalit dhe rreziqeve të lidhura me to. Rreziku i tregut rrjedh nga pozicionet e hapura në normat e interesit dhe në monedhë të huaj që janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve specifike dhe të përgjithshme të tregut dhe ndryshimit në nivelin e paqëndrueshmërisë të çmimeve të tregut. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është për të administruar dhe kontrolluar ekspozimet e rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, në optimizmin e kthimit .

Rreziku i monedhës

Shoqëria ka aktive dhe detyrime të shprehura në Euro. Rreziku i monedhës së huaj lind kur aktivet aktuale ose të parashikuara në një monedhë të huaj janë ose më të mëdha, ose më të vogla se detyrimet në këtë monedhë. Ndikimi i rrezikut të normës së këmbimit valutor mbi Shoqërinë është kufizuar në monedhën Lek dhe Euro. Kurset më të rëndësishme të këmbimit kanë qenë si më poshtë:

Lek	Kursi mesatar	Kursi në datën e raportimit
	2019	2019
EUR 1	123.01	121.77
GBP 1	143.00	140.25
	2018	2018
EUR 1	127.59	123.42
GBP 1	144.21	137.42

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të monedhës së huaj bazuar në shuma nominale është si në vijim:

31 dhjetor 2019	Lek	EUR	GBP	Totali
Aktive Financiare				
Të arkëtueshme tregtare	229,792,785	-	-	229,792,785
Të arkëtueshme të tjera	-	41,678,241	-	41,678,241
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	40,567	8,516,897	-	8,557,464
	229,833,352	50,195,138	-	280,028,490
Detyrime financiare				
Të pagueshme tregtare	27,420,415	64,449,483	24,287,749	116,157,647
Hua	82,425,267	-	-	82,425,267
	109,845,682	64,449,483	24,287,749	198,582,914
Pozicioni Neto	119,987,670	(14,254,345)	(24,287,749)	81,445,576
31 dhjetor 2018				
Aktive Financiare				
Të arkëtueshme tregtare				
Të arkëtueshme të tjera	350,619,077	-	-	350,619,077
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	-	35,423,866	-	35,423,866
	7,874,870	8,045,651	-	15,920,521
Detyrime financiare	358,493,947	43,469,517	-	401,963,464
Të pagueshme tregtare				
Hua	66,858,114	54,115,097	31,257,229	152,230,440
	83,538,318	-	-	83,538,318
Pozicioni neto	150,396,432	54,115,097	31,257,229	235,768,758

British American Tobacco – Albania Shpk
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

8. Instrumentet financiare – vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)

(b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(iv) Rreziku i tregut (vazhdim)

Analiza e ndjeshmërisë

Një forcim apo dobësim i lekut, si tregohet më poshtë, kundrejt Euros dhe GBP në 31 dhjetor do të ndikojë respektivisht në zvogëlim ose rritje të kapitalit dhe fitim/humbjes me shumat e treguara më poshtë. Kjo analizë bazohet në luhatshmërinë e normave të kurseve të këmbimit dhe një lëvizje prej 10% konsiderohet e arsyeshme nga Shoqëria në fund të periudhës raportuese.

<i>në Lek</i>	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	Equity	Profit or loss	Equity	Profit or loss
EUR	(1,211,619)	(1,211,619)	(904,874)	(904,874)
GBP	(2,064,459)	(2,064,459)	(2,656,864)	(2,656,864)

Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është rreziku që lëvizjet në normat e interesit do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqërisë ose në vlerën e portofolit të instrumenteve financiarë. Duke qenë se Shoqëria nuk ka aktive që mbartin rrezik të rëndësishëm, të ardhurat e Shoqërisë dhe flukset operative janë kryesisht të pavarura nga ndryshimet në normat e interesit të tregut. Ndryshimet në normat e interesit ndikojnë kryesisht në huamarrjet me normë interesi fikse, duke ndryshuar vlerën e tyre të drejtë. Drejtimi nuk ka një politikë formale që përcakton se sa huamarrje duhet të jenë me normë interesi fikse apo të ndryshueshme. Megjithatë, kur merren hua të reja drejtimi përdor gjykimin e tij për të vendosur nëse beson se një normë interesi fikse ose e ndryshueshme do të jetë më e përshtatshme për Shoqërinë gjatë periudhës së pritshme deri në maturim.

Profili i normës së interesit që mban Shoqëria për instrumentet financiare mbartëse të interesit në datën e raportimit është si më poshtë:

	Vlera e mbetur më 31 dhjetor	
	2019	2018
Huatë (normat e ndryshueshme)	82,425,267	83,538,318
	82,425,267	83,538,318

Më 31 dhjetor 2019, një rritje (rënie) e mundshme e arsyeshme me 100 pikë bazë në normat e interesit, me të gjithë faktorët e tjerë të mbajtur të pandryshuar, do të kishte një rënie (rritje) të kapitalit dhe fitimit ose humbjes para tatimit me 824,253 Lekë (2018: 835,383 Lekë).

(v) Administrimi i kapitalit

Objektivat e Shoqërisë në administrimin e kapitalit janë ruajtja e aftësisë së Shoqërisë sipas parimit të vijimësisë në mënyrë që të sigurojë një fitim për pronarët dhe të mbajë një strukturë optimale të kapitalit për të ulur koston e tij. Kostoja totale e kapitalit llogaritet si pjesa e kapitalit të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar plus borxhin neto. Borxhi neto llogaritet si totali i huave paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar minus mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre. Për të ruajtur apo përshtatur strukturën e kapitalit, Grupi mund të përshtatë sasinë e dividendit të paguar aksionarëve ose mund të nxjerrë aksione të reja apo të shesë aksione për të zvogëluar borxhet.

Shoqëria është financuar me kapital dhe kryesisht me financime nga palët e lidhura. Politikat e zbatuara synojnë që Shoqëria të jetë në gjendje të paguajë borxhet dhe detyrimet në lidhje me shpenzimet në investimet kapitale kur ato maturohen.

Shoqëria nuk është subjekt i ndonjë kërkese të jashtme lidhur me kapitalin.

(vi) Parimi i vijueshmërisë

Më 31 dhjetor 2019, Shoqëria kishte akumuluar humbje prej 122,041,139 Lekë (2018: 133,761,138 Lekë), kryesisht si rezultat i humbjeve të krijuara në vitet e mëparshme. Gjatë 2019 dhe 2018, Shoqëria ka qenë fitimprurëse. Shoqëria pret që të ardhurat të rriten më tej në 2020. Gjatë vitit 2019, Shoqëria ka gjeneruar flukse neto monetare pozitive neto nga veprimtaritë e saj operative në shumën prej 4,710,735 Lekë (2018: flukse monetare negative prej 69,621,679 Lekë).

British American Tobacco – Albania Shpk
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

8. Instrumentet financiare – vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)

(b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(vi) Parimi i vijueshmërisë (vazhdim)

Zhvillimi i shpejtë i virusit Covid-19 dhe ndikimi i tij social dhe ekonomik në Shqipëri dhe globalisht mund të rezultojë në supozime dhe vlerësime që duhen rishikuar. Të tilla rishikime mund të çojnë në rregullime materiale të vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Në veçanti, drejtimi pret që të ndikohen supozimet dhe vlerësimet e përdorura në përcaktimin e humbjeve të pritura kreditore. Në këtë fazë, drejtimi nuk është në gjendje të vlerësojë në mënyrë të besueshme ndikimin, pasi ngjarjet po shpalosen dita-ditës.

Ndikimi më afatgjatë mund të ketë sjellë pasoja negative në vëllimet e tregtisë, flukset e mjeteve monetare dhe përfitueshmërisë. Sidoqoftë, në datën e raportimit të këtyre pasqyrave financiare, Shoqëria vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në afat.

Prandaj, drejtimi i Shoqërisë gjykon se nuk ekziston pasiguri e rëndësishme lidhur me ngjarjet dhe rrethanat që mund të ngrenë dyshime mbi vijimësinë e Shoqërisë dhe për pasojë i ka përgatitur pasqyrat financiare mbi parimin e vijimësisë.

9. Aktivët afatgjatë materiale

	Pajisje zyre dhe mobilje	Pajisje IT	Mjete transporti	Totali
Kosto				
Më 1 janar 2018	9,692,528	20,253,812	31,887,308	61,833,648
Shtesa	-	1,456,776	-	1,456,776
Pakësime	-	(55,414)	-	(55,414)
Më 31 dhjetor 2018	9,692,528	21,655,174	31,887,308	63,235,010
Shtesa	-	806,683	-	806,683
Pakësime	-	-	(4,568,837)	(4,568,837)
Më 31 dhjetor 2019	9,692,528	22,461,857	27,318,471	59,472,856
Amortizimi i akumuluar				
Më 1 janar 2018	(8,786,770)	(19,344,550)	(24,413,205)	(52,544,525)
Shpenzime të vitit	(180,272)	(1,131,512)	(3,477,939)	(4,789,723)
Pakësime	-	55,413	-	55,413
Më 31 dhjetor 2018	(8,967,042)	(20,420,649)	(27,891,144)	(57,278,835)
Shpenzime të vitit	(148,080)	(901,587)	(2,522,988)	(3,572,655)
Pakësime	-	-	4,568,837	4,568,837
Më 31 dhjetor 2019	(9,115,122)	(21,322,236)	(25,845,295)	(56,282,653)
Vlera kontabël neto				
Më 1 janar 2018	905,758	909,262	7,474,103	9,289,123
Më 31 dhjetor 2018	725,486	1,234,525	3,996,164	5,956,175
Më 31 dhjetor 2019	577,406	1,139,621	1,473,176	3,190,203

Shpenzimet e amortizimit janë përfshirë në shpenzimet tregtare si dhe në shpenzimet administrative në fitim ose humbje, të ndara sipas qendrave të kostove.

Nuk ka asnjë element të AAM të mbajtura peng si garanci për huamarrjet me 31 dhjetor 2019 dhe 2018.

10. Aktive me të drejtë përdorimi

(a) Shih shënimin 7 (h).

	Ndërtesa	Mjete transporti	Totali
Kosto			
Më 1 janar 2019 në zbatimin fillestar të SNRF 16	22,304,802	-	22,304,802
Shpenzime amortizimi për vitin	(11,152,401)	-	(11,152,401)
Shtesa në aktive me të drejtë përdorimi	-	8,363,432	8,363,432
Çregjistrimi e aktiveve me të drejtë përdorimi	-	-	-
Më 31 dhjetor 2019	11,152,401	8,363,432	19,515,833

British American Tobacco – Albania Shpk
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

10. Aktive me të drejtë përdorimi (vazhdim)

(b) Shumat e njohura në fitim humbje janë paraqitur më poshtë:

Shumat e njohura në fitim humbje dhe të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse	In Lek
2019 - Qiratë sipas SNRF 16	
Shpenzime amortizimi për aktivet me të drejtë përdorimi (shih (a))	11,152,401
Shpenzimet e interesit për detyrimet e qirasë (shih Shënimin 26)	775,436
Shpenzimet e qirasë për vlera të ulëta dhe qira afatshkurtra	-
2018 - Qiratë Operative sipas SNK 17	
Shpenzimet e qirasë (shih Shënimin 24)	11,462,913

11. Inventarët

	2019	2018
Mallra të gatshëm	512,053,048	374,016,224
Pulla fiskale të akcizës	12,909,784	13,495,296
	<u>524,962,832</u>	<u>387,511,520</u>

Më 31 dhjetor 2019, mallrat e gatshëm prej 512,053,048 Lekë (2018: 374,016,224 Lekë) përfshijnë cigare të importuara, të cilat menjëherë pasi importohen, mbahen lokalisht si inventarë.

12. Të arkëtueshme tregtare

	2019	2018
Llogari tregtare të arkëtueshme	267,005,070	385,603,454
Zbritja - fondi i zhvlerësimit	(34,791,575)	(34,791,575)
Zbritja – fondi i zhvlerësimit për humbjet e pritshme kreditore	(2,420,710)	(192,802)
	<u>229,792,785</u>	<u>350,619,077</u>

Të arkëtueshmet tregtare përfshijnë shumat e arkëtueshme nga THG për shitjen e cigareve. Shih shënimin 8(b)(ii) për më shumë detaje lidhur me llogaritë e arkëtueshme dhe administrimin e rrezikut kreditor.

Shuma 34,791,575 lek përbëhet nga zbritja - fondi i zhvlerësimit e njohur për mallrat e dëmtuara që i janë shitur distributorit. Shoqëria është nën një proces gjyqësor për rimbursimin e akcizës së lidhur me këto mallra, për të vijuar më pas me shkatërrimin e tyre dhe shlyerjen e shumës.

13. Aktive të tjera

	2019	2018
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura (shih Shënimin 29)	41,678,241	35,423,866
Aktivet financiare	<u>41,678,241</u>	<u>35,423,866</u>
Parapagime për akcizën dhe detyrime doganore	-	10,000,000
Parapagime për tatime	45,049,373	12,120,655
Parapagime të tjera	785,168	785,168
Aktive jo-financiare	<u>45,834,541</u>	<u>22,905,823</u>
	<u>87,512,782</u>	<u>58,329,689</u>

Nuk ka patur parapagime të akcizës dhe detyrimeve doganore më 31 dhjetor 2019. Balanca më 31 dhjetor 2018 përfshin shumën e parapaguara autoriteteve doganore për blerjen e mallrave të importeve të para të vitit 2019. Parapagimet për tatimet lidhen kryesisht me TVSH-në.

14. Mjete monetare edhe ekuivalente me to

	2019	2018
Llogari rrjedhëse me bankat		
– Në Lek	40,567	7,874,870
– Në Euro	8,516,897	8,045,651
	<u>8,557,464</u>	<u>15,920,521</u>

Shoqëria ka llogari rrjedhëse në OTP Bank Albania (ish Societe Generale) dhe Raiffeisen Bank Albania.

British American Tobacco – Albania Shpk
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

15. Kapitali aksionar

	Pronësia	Kapitali aksionar	
		2019	2018
British American Tobacco International Holdings B.V.	100%	552,341,000	552,341,000

Më 31 dhjetor 2019, kapitali aksionar i Shoqërisë është 552,341,000 Lekë (2018: 552,341,000 Lekë) dhe është i ndarë në 552,341 aksione me vlerë nominale 1,000 Lekë secili. Kapitali është plotësisht i paguar.

16. Të pagueshme tregtare

	2019	2018
Tobacco Holdings Group Shpk	7,011,785	5,647,332
Furnitorë të shërbimeve	7,129,242	6,207,347
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura (Shënimi 29)	102,016,620	140,375,761
	116,157,647	152,230,440

17. Detyrimet e qirasë

Termt dhe kushtet e detyrimeve të papaguara të qirasë më 31 dhjetor 2019 janë si më poshtë:

	Monedha	Norma rritëse e interesit	Viti i maturimit	Pagesat minimale mujore të qirasë	
				Në monedha të tjera	Në monedhën lokale ('000)
Detyrimet e qirasë	EUR	4.50%	2021-2024	8,742	1,064,513

Më poshtë janë paraqitur flukset dalëse të paskontuara për shlyerjet e detyrimeve të qirasë, sipas vitit të maturimit:

	31 dhjetor 2019
- Më pak se një vit	-
- Ndërmjet një dhe dy vjet	10,922,769
- Ndërmjet dy dhe tre vjet	-
- Ndërmjet tre dhe katër vjet	-
- Ndërmjet katër dhe pesë vjet	9,362,025
- Më shumë se pesë vjet	-
	20,284,794
Minus shpenzime interesi të ardhshme	(1,258,527)
Detyrimi i qirasë financiare	19,026,267

18. Detyrime të tjera

Detyrime të tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë të detajuara si më poshtë:

	2019	2018
Të pagueshme ndaj personelit	15,132,141	16,310,882
Shpenzime marketingu të përllogaritura	16,220,150	23,223,559
Detyrime të tjera të shtyra	69,261,601	28,373,190
Shpenzime të përllogaritura për marzhin e distributorit dhe kostot e prokurimeve	57,181,644	26,381,699
Detyrime Financiare	157,795,536	94,289,330
Taksa të tjera të pagueshme përveç tatimit në fitim	744,922	2,520,098
Detyrime jo-financiare	744,922	2,520,098
	158,540,458	96,809,428

Shpenzimet e përllogaritura për marzhin e distributorit dhe kostot e prokurimeve më 31 dhjetor 2019 përfshijnë marzhin e tregueseve kryesor të performancës (TKP) dhe 2/3 e super bonusit të alokuar për distributorin sipas marrëveshjes së shpërndarjes së ndryshuar për periudhën 2019 deri në vitin 2020.

British American Tobacco – Albania Shpk
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

19. Provizionet

	<u>2019</u>	<u>2018</u>
Gjendja më 1 janar	74,656,441	75,789,206
Provizionet të njohura gjatë vitit	8,346,328	11,371,472
Provizionet e rimarra gjatë vitit	(9,181,349)	(12,504,238)
Balanca më 31 dhjetor	<u>73,821,420</u>	<u>74,656,440</u>

Provizionet lidhen me detyrime të mundshme të vlerësuara nga drejtimi. Vlerësimet bazohen në interpretimet e legjislacionit tatimor në fuqi ose që hyjnë në fuqi në fund të periudhës së raportimit, si dhe mbi vendime gjyqësore e të tjera në lidhje me to (shiko Shënimin 28).

20. Huatë

	<u>2019</u>	<u>2018</u>
Huatë	82,425,267	83,538,318
	<u>82,425,267</u>	<u>83,538,318</u>

Shoqëria ka një linjë kredie me BAT WECT me maturim më 1 qershor 2020, me një limit prej 300,000 mijë lekë dhe një normë interesi të ndryshueshme 3M Bono Thesari Shqiptare + 2.66% në vit. Një tarifë angazhimi prej 0.931% në vit është e pagueshme mbi shumën e patërhequr. Më 31 dhjetor 2019 norma e interesit të huasë është 1.45 % në vit (2018: 1.47 % në vit).

Tabela më poshtë tregon një rilloaritje të lëvizjeve të detyrimeve ndaj flukseve të mjeteve monetare që rrjedhin nga aktivitetet e financimit.

<i>Shumat në Lek</i>	<u>Hua</u>
Gjendja më 1 janar 2018	208,848,505
<i>Ndryshime nga flukset monetare financuese</i>	
Ripagesat neto të huave	(126,249,998)
Ndryshimet totale nga flukset monetare financuese	<u>(126,249,998)</u>
Ndryshime të tjera	
Shpenzime interesi (shënimi 25)	7,360,554
Interesi i paguar	(6,420,743)
Gjendja më 1 janar 2019	83,538,318
<i>Ndryshime nga flukset monetare financuese</i>	
Ripagesat neto të huave	-
Ndryshimet totale nga flukset monetare financuese	-
Ndryshime të tjera	
Shpenzime interesi (shënimi 25)	5,795,474
Interesi i paguar	(6,908,525)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	<u>82,425,267</u>

21. Të ardhurat

Shumat totale të faturuara janë si më poshtë:

	<u>2019</u>	<u>2018</u>
Çmimi i publikuar i shitjes me pakicë	3,487,019,024	3,217,121,850
Minus: zbritjet tregtare	(594,050,723)	(531,208,311)
Të ardhurat nga shitjet	<u>2,892,968,301</u>	<u>2,685,913,539</u>

Sipas ligjit dhe udhëzimeve në fuqi mbi TVSH-në, shitjet e cigareve janë faturuar nga Shoqëria tek Klienti me çmimin përfundimtar të publikuar të shitjes me pakicë, minus çdo komision të ndërmjetëm tregtar, siç janë komisionet e shitjes me shumicë dhe pakicë.

British American Tobacco – Albania Shpk
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

22. Kosto e shitjes

Kosto e shitjes përbëhet nga:

	2019	2018
Shpenzime të blerjes së cigareve	431,147,559	454,998,885
Akciza	2,092,613,250	1,872,431,250
Shpenzime edhe detyrime të tjera	108,163,575	100,729,619
	<u>2,631,924,384</u>	<u>2,428,159,754</u>

Shpenzime edhe detyrime të tjera përbëhen nga detyrime doganore që lidhen me koston e skanimit dhe printimit.

23. Shpenzime tregtare

Shpenzimet sipas natyrës janë prezantuar si më poshtë:

	2019	2018
Shpenzime për tregtimin dhe mbështetjen e markës	63,891,225	42,302,592
Shpenzime personeli	26,931,381	29,278,410
Shërbime të jashtme	1,800,239	3,369,881
Shpenzime utilitare dhe të konsumueshme të tjera	3,093,646	4,029,157
Qira	-	4,028,307
Amortizimi	2,295,459	2,679,353
Amortizimi i aktiveve me të drejtën e përdorimit	5,408,355	-
Udhëtime dhe aktivitete	5,574,161	5,968,650
Shpenzime konsulence, ligjore dhe trajnimi	6,036,196	3,961,324
Të tjera	1,012,763	5,346,696
	<u>116,043,425</u>	<u>100,964,370</u>

24. Shpenzime administrative

Shpenzimet sipas natyrës janë të prezantuara si më poshtë:

	2019	2018
Shpenzime për teknologjinë e informacionit (TI)	88,494,207	61,202,159
Shërbime profesionale	44,818,193	40,880,940
Shpenzime personeli	26,331,959	24,638,546
Shpenzime për provizione (Shënimi 19)	(835,021)	(1,132,766)
Shërbime të jashtme	9,362,591	9,800,773
Shpenzime konsulence, ligjore dhe trajnimi	3,837,028	2,622,599
Shpenzime të auditimit	1,359,386	1,344,381
Qira	-	7,434,606
Udhëtime dhe aktivitete	4,363,468	7,141,675
Shpenzime utilitare dhe të konsumueshme të tjera	7,369,058	6,827,557
Amortizimi	1,277,196	2,110,370
Amortizimi i aktiveve me të drejtën e përdorimit	5,744,046	-
Riparime dhe mirëmbajtje	2,400	1,856,927
Shpenzime të tjera	3,096,217	10,475,650
Shpenzim për humbjet nga zhvlerësimi për të arkëtueshmet tregtare	(59,294)	9,391
	<u>195,161,434</u>	<u>175,212,808</u>

Shpenzimet profesionale janë për shërbime financiare dhe ekzekutive të ofruara nga palë të lidhura dhe shpenzimet për TI lidhen kryesisht me implementimin e një sistemi me bazë SAP-in për planifikimin e burimeve të ndërmarrjes, të integruar me të gjitha entitetet e BAT.

British American Tobacco – Albania Shpk
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

24. Shpenzime administrative (vazhdim)

Në tabelën në vijim janë paraqitur shumat totale të shpenzimeve për kompensimin e punonjësve, të përfshira në shpenzimet e tregtare dhe shpenzimet administrative:

	<u>2019</u>	<u>2018</u>
Pagat	31,849,030	34,447,993
Kontribute për sigurimet Shoqërore dhe shëndetësore	3,120,565	3,348,348
Shpërblime	14,725,484	10,283,642
Të tjera	3,568,261	5,836,973
Totali	<u>53,263,340</u>	<u>53,916,956</u>

Deri më 31 dhjetor 2019, Shoqëria ka punësuar 12 punonjës, nga të cilët 10 në role manaxheriale (31 dhjetor 2018: 15 punonjës, nga të cilët 13 në role manaxheriale).

25. Të ardhura të tjera operative

	<u>2019</u>	<u>2018</u>
Fitimi neto nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	597,518	-
Të ardhura nga shërbimet e rimbursuara (Shënimi 28)	80,457,513	49,059,151
Rimarrja e detyrimeve të përlllogaritura të periudhave të mëparshme	-	2,638,141
Rimbursim taksash	-	1,198,412
	<u>81,055,031</u>	<u>52,895,704</u>

Gjatë vitit 2019, të ardhurat nga shërbimet e rimbursuara përbëhen nga shërbime të mbështetjes së drejtimit dhe shërbime të tjera lidhur me shpërndarjen, marketingun dhe shitjen e produkteve të BAT në Kosovë dhe Maqedoni. Rritja gjatë vitit 2019 ka të bëjë me rritjen e aktiviteteve të biznesit për BAT Kosovën që më parë funksiononte si zyrë përfaqësuese për BAT WECT.

26. Shpenzimet financiare neto

	<u>2019</u>	<u>2018</u>
Fitime financiare		
Interesi i përfituar nga depozitat	21,464	21,434
Fitime nga kursi i këmbimit, neto	1,385,038	-
	<u>1,406,502</u>	<u>21,434</u>
Kosto financiare		
Humbje nga kursi i këmbimit, neto	-	(1,361,833)
Pagesa për garanci bankare	(7,566,000)	(7,566,000)
Kostot e huasë	(5,795,474)	(7,360,554)
Interesi për detyrimet e qirasë	(775,436)	-
	<u>(14,136,910)</u>	<u>(16,288,387)</u>
Shpenzime financiare neto	<u>(12,730,408)</u>	<u>(16,266,953)</u>

Rezultati i këmbimit valutor për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 është i detajuar si më poshtë në baza bruto:

	<u>2019</u>	<u>2018</u>
Fitimet e këmbimit valutor	9,776,397	15,320,002
Humbjet e këmbimit valutor	(8,391,359)	(16,681,835)
Fitimet neto të këmbimit valutor / (humbjet)	<u>1,385,038</u>	<u>(1,361,833)</u>

27. Tatimi mbi fitimin

	<u>2019</u>	<u>2018</u>
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	6,443,681	10,503,546
	<u>6,443,681</u>	<u>10,503,546</u>

Shoqëria përcakton tatimin në fund të vitit, sipas legjislacionit tatimor shqiptar. Në vitin 2019, norma e tatimit mbi fitimin në Shqipëri është e barabartë me 15% të rezultatit të tatueshëm (2018: 15%).

British American Tobacco – Albania Shpk
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

27. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Në vijim paraqitet një rakordim midis tatimit mbi fitimin të llogaritur me normën e zbatueshme të tatimit dhe shpenzimit të tatimit mbi fitimin:

	2019		2018	
Fitimi para tatimit		18,163,681		18,205,358
Tatimi mbi fitimin me normën prej 15%	15%	2,724,552	15%	2,730,804
Shpenzimet e panjohura	11%	1,998,686	52%	9,522,760
Ndryshimi në diferencat e përkohshme të panjohura	9%	1,720,443	(10%)	(1,750,018)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	35%	6,443,681	58%	10,503,546

Ndryshimi në diferencat e përkohshme të panjohura prej 1,720,442 Lekë (2018: 1,750,018 Lekë) lidhet me shpenzime të caktuara të njohura për qëllime kontabël, por jo për qëllime tatimore. Megjithëse këto shpenzime mund të zbriten nga rezultati tatimor në të ardhmen, Shoqëria nuk ka njohur ndonjë aktiv të shtyrë tatimor në lidhje me to sepse rezultati i kësaj çështjeje është i pasigurt, pasi është subjekt vlerësimesh të ardhshme nga autoritetet tatimore.

28. Angazhime dhe detyrime të mundshme

Çështjet ligjore

Gjatë rrjedhës normale të biznesit, mund të ngrihen padi kundër Shoqërisë. Bazuar në vlerësimet e tij, Drejtimi është i mendimit që nuk do të shkaktohen humbje materiale në lidhje me këto padi përtej provizioneve të paraqitura në këto pasqyra financiare (shih shënimin 18).

Pozicionet e pasigurta tatimore të Shoqërisë rivlerësohen nga drejtimi në fund të çdo periudhe raportuese. Provizionet për detyrime dhe tarifa janë detyrime jofinanciare me kohën ose shumë të pasigurt dhe regjistrohen për pozicionet tatimore që përcaktohen nga drejtimi si me më shumë mundësi se sa jo që të rezultojnë në tatime shtesë që do të vendosen nëse pozicionet do të kundërshtoheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore që janë miratuar ose janë miratuar në mënyrë thelbësore deri në fund të periudhës raportuese, dhe çdo gjykatë e njohur ose aktvendime të tjera për çështje të tilla. Një provizion i tillë njihet bazuar në vlerësimin më të mirë të drejtimit të shpenzimeve të kërkuara për shlyerjen e detyrimeve në fund të periudhës raportuese. (shiko Shënimin 19).

Detyrimet të mundshme

Shoqëria ka marrë dy letra garancie nga OTP Bank Albania (ish Societe Generale Albania) në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave lidhur me detyrime potenciale të ardhshme ndaj kësaj të fundit me një limit total prej 756,600 mijë Lekë (2018: 756,600 mijë Lekë). Normat vjetore të interesit pa risk për këto garanci janë 1%. Këto garanci do të përdoren në rast se do të lindë një detyrim i ardhshëm. Ato nuk janë përdorur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018.

29. Transaksionet me palët e lidhura

Një palë është e lidhur me një njësi ekonomike nëse: (a) direkt, ose nëpërmjet një apo më shumë ndërmjetësve, pala:(i) kontrollon, kontrollohet nga, ose është nën kontrollin e përbashkët me njësinë ekonomike (kjo përfshin Shoqërinë mëmë, filialet dhe nën-filialet); (ii) ka një interes në njësinë ekonomike që i jep asaj influencë të konsiderueshme mbi njësinë; ose (iii) ka kontroll të përbashkët mbi njësinë ekonomike; (b) pala është një pjesëmarrje e njësisë ekonomike; (c) pala është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën njësi ekonomike është një sipërmarrës; (d) pala është një anëtar i personelit drejtues kryesor të njësisë apo të Shoqërisë mëmë të saj; (e) pala është një familjar i afërt i ndonjë prej individëve referuar pikës (a) ose (d); (f) pala është një njësi ekonomike që kontrollohet, bashkëkontrollohet apo me ndikim të rëndësishëm, ose për të cilën ruan fuqinë më të madhe të votimit, direkt apo indirekt për çdo individ të referuar në (d) ose (e); ose (g) pala është një skemë e përfitimit pas – punësimit për përfitimin e punonjësve të njësisë ekonomike, ose të çdo njësie që është palë e lidhur me njësinë ekonomike. Një transaksion me palët e lidhura është një transferim i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve, pavarësisht nëse është vënë një çmim. Shoqëria mëmë përfundimtare që ka kontrollin mbi Shoqërinë është British American Tobacco plc, me seli në Londër, Mbretëria e Bashkuar. Shoqëria mëmë është British American Tobacco International Holdings B.V. Hollandë.

British American Tobacco – Albania Shpk
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

29. Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)

Transaksionet me palët e lidhura të Shoqërisë janë si më poshtë:

	2019	2018
<i>Të arkëtueshme (Shënimi 13)</i>		
BAT Western Europe Commercial Trading	-	3,216,306
BAT Kosovo Shpk	41,678,241	32,207,560
	41,678,241	35,423,866
<i>Të pagueshme tregtare (Shënimi 16):</i>		
BAT Western Europe Commercial Trading	48,334,934	109,429,562
BASS (GSD) Limited	24,287,749	4,285,158
BASS Europe SRL	3,854,581	(311,030)
BAT Romania Trading Srl	25,539,356	26,972,071
	102,016,620	140,375,761
<i>Hua (Shënimi 19)</i>		
BAT Western Europe Commercial Trading	82,425,267	83,538,318
	82,425,267	83,538,318
<i>Të ardhura (Shënimi 24)</i>		
BAT Western Europe Commercial Trading	-	16,851,591
BAT Kosovo Shpk	80,457,513	32,207,560
	80,457,513	49,059,151
<i>Shpenzime operative</i>		
Shpenzime për blerjet e cigareve (Shënimi 21)	431,147,559	454,998,885
Shpenzime administrative	88,494,207	61,202,159
Shpenzime konsulence, ligjore dhe trajnimi	44,818,192	40,880,940
	564,459,958	557,081,984
<i>Kosto financiare (shënimi 25)</i>		
BAT Western Europe Commercial Trading	(5,795,474)	(7,360,554)
<i>Transaksione me drejtimin</i>		
Drejtesit kryesorë janë ata persona që kanë autoritetin dhe përgjegjësinë për planifikim, drejtim dhe kontroll të aktiviteteve të Shoqërisë, drejtpërdrejt ose jo, duke përfshirë Administratorin. Drejtesit kryesorë kanë marrë pagesat e mëposhtme gjatë vitit, të cilat janë përfshirë në shpenzimet administrative dhe tregtare:		
	2019	2018
Shpenzime page dhe shpërblime	5,081,309	4,245,392
Kontributet e sigurimeve Shoqërore dhe shëndetësore	270,720	246,559
	5,352,029	4,491,951

30. Ngjarje pas datës së raportimit

Pas 31 dhjetorit 2019, në datën 11 mars 2020 “Organizata Botërore e Shëndetësisë” shpalli gjendjen e pandemisë botërore, si pasojë e shfaqjes dhe përhapjes së koronavirusit Covid-19 në fillim të vitit 2020. Drejtimi ka vlerësuar se nuk ka asnjë ndikim negativ nga kjo ngjarje për Shoqërinë që do të kërkojë rregullim ose paraqitje shtesë, përveç atyre të përshkruara në shënimin 8 (b) (v).

Drejtimi i Shoqërisë nuk është në dijeni për ndonjë ngjarje tjetër pas datës së raportimit që do të kërkojë rregullim apo paraqitje në pasqyrat financiare.